



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede /
Agriculture Development Agency

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN / KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për kulturat bujqësore (grurë, farë gruri, misër, luledielli, perime në fushë të hapur dhe pemishte ekzistuese)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdoj të mbështes fermerët përmes Pagesave Direkte. Niveli i mbështetjes do të jetë:

Pagesa Direkte - Grurë: 150 €/ha
Pagesa Direkte - Farë gruri: 250 €/ha
Pagesa Direkte - Misër: 150 €/ha
Pagesa Direkte - Luledielli: 150 €/ha
Pagesa Direkte - Perime në fushë të hapur: 300 €/ha
Pagesa Direkte - Pemishte ekzistuese: 400 €/ha

Fermerët që aplikojnë për Pagesa Direkte për kulturat bujqësore duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellur së paku 2 ha me grurë;
- Të kenë të mbjellur së paku 1 ha tokë me misër;
- Të kenë të mbjellur së paku 1 ha tokë me luledielli;
- Të kenë të mbjellur së paku 5 ha me grurë për prodhimin e farës së grurit;
- Të kenë të mbjellur së paku 0.50 ha me perime në fushë të hapur;
- Të kenë të mbjellur së paku 0.50 ha me pemë dru-frutore;
- Të kenë të mbjellur së paku 0.25 ha me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, mjedër dhe boronicë);
- Parcelat e mbjella me grurë, misër, luledielli dhe perime në fushë të hapur duhet të jenë së paku 0.20 ha;
- Parcela e mbjellë me grurë për prodhimin e farës së grurit, duhet të jetë së paku 1 ha e pandarë;
- Parcela e mbjellë me pemë dru frutore dhe pemë të imëta duhet të jetë së paku 0.25 ha;

- Fara e mbjellur e grurit duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës;
- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira për grurë, farë gruri, misër dhe luledielli duhet të jetë 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e pemishtes e marrë me qira duhet të jetë minimum 0.25 ha e pandarë;
- Sipërfaqja e tokës bujqësore, e cila është marrë me qira, duhet të dokumentohet përmes kontratës së lidhur ndërmjet palëve dhe përmes fletës poseduese;
- Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit.

Kulturat perimore që kultivohen në fushë të hapur dhe që do të mbështeten përmes pagesave direkte janë:

Nr	Emri i kulturës perimore
1	Patatja
2	Domatja
3	Patëlxhani i zi
4	Speci
5	Kungulli i misrit
6	Kungulli
7	Kungullesha
8	Trangulli
9	Shalqini
10	Pjepri
11	Lakra
12	Lulelakra
13	Spinaqi
14	Marulla (sallata)
15	Pangjari
16	Magdanozi
17	Preshi
18	Qepa
19	Rrepka
20	Hudhra
21	Fasulja
22	Bizelja
23	Karrota

Kulturat pemëtare që do të mbështeten përmes pagesave direkte janë:

Nr	Emri i kulturës pemëtare
1	Molla
2	Dardha

3	Ftoi
4	Mushmolla
5	Kumbulla
6	Kajsia
7	Pjeshka
8	Qershia
9	Vishnja
10	Dredhëza
11	Manaferra
12	Mjedra
13	Boronica

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka se llogaria është rrjedhëse dhe aktive;
- Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi (fletën poseduese);
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Kontrata për sipërfaqen e marrë me qira, duke bashkangjitur fletën poseduese të qiradhënësit;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike, nga data 25 shkurt deri më 10 prill 2015.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Për të gjitha Pagesat Direkte duhet të bëhet digjitalizimi i parcelave përmes programit sLPIS.

Një fermer duhet ta ketë vetëm një aplikacion.

Gjatë procedurës së kontrollit në terren, në rast të gjetjes së shkeljeve, do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar Udhëzimin Administrativ përkatës për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë për vitin 2015.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.